REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS
REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA
MARRË NË DORËZIM - PRANUAR - RECEIVED
Nr. org. Org. Jedinice Org. Unit | Numri Broj Number | Shtojca Prilog Appendix | Vlera Vrednost Value
01 | 351 | 66424 | 2

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA SUHAREKË

KOMUNA SUHAREKË, të cilën e përfaqëson Bujar Kuçi, shef i zyrës së Prokurimit dhe menaxheri i kontratës i caktuar me Aktvendim nga ZKA ne PMK[1] (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

dhe

ISEFERI shpk & I.SEFERI shpk me seli ne Suharekë me NRB: 810106204 të cilën e përfaqëson Idriz Seferaj (ne vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

SANIMI I GJENDJES NE INFRASTRUKTURË PAS VERSHIMEVE
Lot/Pjesa -1 Kanali i mbylluri "Gryka e Dybiqakut"
Nr i prokurimit 624-18-090-515 /624-18 7356--515

Neni 1 Lënda

1.1 Lëndë e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **LOT/ PJESA 1 Kanali i mbyllur "Gryka e Dybiqakut"**, sipas specifikimeve teknike te dosjes se tenderit dhe bazuar ne gjendjen e krijuar pas reshjeve, te pershkruara ne kerkesat e njesise dhe vendimin e ZKA-se, perfshire edhe njoftimet qe jane bere ne KRPP.

1.2 Punët duhet të përfundojnë sipas dinamikës së përcaktuar nga njësia e kërkesës, me se largu brenda 45 ditë pune dhe sipas dinamikes se përcaktuar nga menaxheri i projektit ne PMK.

1.3 Operatori ekonomik para nënshkrimit te kontratës duhet të sjell sigurimin e ekzekutimit 10% të vlerës së kontratës per nje periudhe prej: **90 ditësh.**

1.4 E.O është i obliguar te bashkëpunoj me menagjerin e kontratës te Autoritetit Kontraktues dhe zyrën e prokurimit. OE është i obliguar të njoftoj zyrën e prokurimit dhe menagjerin e projektit, nëse projekti kapital nuk është duke u realizuar konformë kontratës dhe specifikimeve dhe paramanave të dhëna me kontratë.

[1] PMK Plani Menaxhimit te Kontrates

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 392.805,56 € (treqind e nëntëdjetë e dymijë e tetëqind e pesë euro e pesëdhjetë e gjashtë cent).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

2.4 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesën në euro, sipas faturave te dorëzuara së bashku me raportin e nënshkruar nga mbikëqyrësi dhe menaxheri i kontratës, në llogarinë bankare të OE: Nr.Llog: **NLB BANK Nr: 1705001013152016.**

2.5 Pagesa e fundit në vlerë jo më pak se 10% vlerës së kontratës do të bëhet me raportin e mbikëqyrësit dhe menaxherit të projektit dhe raportin e pranimit teknik nga komisioni përkatës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Marrëveshja e kontratës;
(b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
(c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
(d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
(e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
(f) (Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës se vendit)
(g) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit*].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton",

"vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe[2]] në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

4.5 Numri kontaktues i OE është 044304 704

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	**Bujar Kuçi**
Pozita:	**Shef i zyrës së Prokurimit**
Nënshkrimi:	
Data:	**16.10.2018**
	vv

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	**Idriz Seferaj**
Pozita:	**Përfaqësues**
Nënshkrimi	
Data:	**16.10.2018**
	vv

Emri:	**Bali Muharremaj**
Pozita:	**ZKA i AK / Kryetar i Komunes**
Nënshkrimi:	
Data:	**16.10.2018**
	vv

[2] Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	**SANIMI I GJENDJES NE INFRASTRUKTURË PAS VERSHIMEVE** **Lot/Pjesa -1 Kanali i mbylluri "Gryka e Dybiqakut"** **Nr i prokurimit 624-18-090-515 /624-18 7356--515**
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës se kontratës me vlefshmëri prej 3 muaj.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 3 ditë nga data e pranimit te kërkesës se Menaxherit te projektit.

Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë *2 dite pas nenshkrimit te kontrates, nese nuk specifikohet ndryshe ne PKM.*
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të **jetë** 45 **ditë** pune, ndersa me PMK munde te shkurtohet ky afat nese palet pajtohen. -OE duhet te kete parasysh gjendjen e krijuar, dhe ti respektoje afatet e percaktuara nga AK sepse bazuar ne sqarimet e njesise mosintevrnimi me kohe ne keto pjese rrezikon perseri vershime dhe kjo drejperdrejt ndikon ne qellimin per te cilin eshte nenshkruar kjo kontrate.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: Berat Kabashi nga DSHPE
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës se kontratës (me sigurim ekzekutimi).
Vërtetimet e pagesë	28	28.1 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit. 28.2. Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë *3* ditë.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 365 ditë pas pranimit teknik.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	ZP Komuna Suhareke ose Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

Për:	**ZYREN E PROKURIMIT KOMUNA SUHAREKË**
Nga:	**ISEFERI shpk & I.SEFERI shpk me seli ne Suharekë**
Lënda:	**DEKLERATË PER KUALITETIN E PUNIMEVE**
Datë:	**16.10.2018**

I/e nderuar,

Kjo deklaratë bëhet në pajtim me Kontratën:

Titulli i kontratës
SANIMI I GJENDJES NE INFRASTRUKTURË PAS VERSHIMEVE
Lot/Pjesa -1 Kanali i mbylluri "Gryka e Dybiqakut"
Nr i prokurimit 624-18-090-515 /624-18 7356--515

Për të përmbushur obligimet që dalin nga neni 27 pika 1 dhe 34.5 (KVK) e kontratës së lartcekur.

Ne konfirmojmë se:

Ne si Operator Ekonomik pas pranimit teknik ofrojmë garancion të rregullt 1 vjeçar, duke siguruar garancion prej 10 % nga vlera e kontratës, si dhe deklarojmë mbi cilësinë e punës dhe mallrave në kohëzgjatje 1 vjet nga dita e pranimit teknik dhe obligohemi dhe pranojmë se defektet e paraqitura gjatë afatit garantues do t'i sanojmë në kohën sa më të shkurtër dhe pa asnjë kompensim. Në të kundërtën ne pajtohemi se AK ato dëme do t'i sanojë me tjetër OE dhe të njëjtat shpenzime do të na faturojë ne si Kontraktor që kemi dhënë këtë deklaratë mbi garantimin e punëve.

Me respekt:

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit : Ilir Horha **Nënshkrimi** _____

Datë: 16.10.2018

V.V "ISEFERI" SH.P.K. Gjinoc - SUHAREKË

LOT/PJESA1 KANALI I MBYLLUR-"Gryka e Dybiqakut"

PARAMASA ME PARALLOGARI

OBJEKTI: KANALI I MBYLLUR -133 m, - I HAPUR 667 m

Vereitje: Te gjitha punet dhe materialet duhet te punohen sipas standardeve teknike , normave ndertimore dhe ligjit te ndertimit ne Kosove

Pjesë përbërese e paramasës janë edhe: PËRSHKRIMI TEKNIK I PUNIMEVE, PROJEKTI DETALET, SKEMAT GRAFIKE DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE. Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin, testimet si dhe kompletimin e certifikatave dhe deklaratave të prodhuesëve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaria e kasive përfundimtare do të bëhet me kërkesë ndërtimore pas përfundimit të rregullohen të pozicioni.

nr.	Përshkrimi i punëve	Njesia	Sasia	Çmimi njesi	Vlera
A	**Strukturat e punes**				
A1.	**MOBILIZIMI NE PUNISHTE**				
A1.1	Mobilizimi ne punishte ,shkarkimi i terenit per ndertim kufizimi i vendpunishtes perballes ,ku do te vendosen objekti mekanizmi makineria	Komplet	1.00	200.00	200.00
A1.2	Furnizimi dhe vendosja e tabelos se vendpunishtes me dimensione :(1,2 x 1,2) m, duke i vendosur shenimet e kontrates	Komplet	1.00	200.00	200.00
A1.3	Hapja e gjeodezik i trases se kanalit vendosja e pikesimit ne teren ,si dhe perjellja e tyre gjate ekzekutimit	Komplet	700.00	0.50	350.00
A1.4	Pastrimi i traseve nga arbushet	Komplet	1.00	200.00	200.00
				TOTAL:	950.00
I.	**PUNET E DHEUT dhe SHTRESAT E ZHAVORIT**				
I.1	Germimi i thelle i tokes kategorine-II deri III- sipas standardit për hapjen e hapesires për kanale te hapura sipas specifikacioni teknik dhe projekt të detajzuar. Ne llogaritje duhet të përfshirë edhe transporti i dheut të tepërt ne vendin e caktuar nga Autoriteti kontraktues i avalonzuar - deponi te materialeve te ngurta " *Kanali 667mx0.66m3	m³	4,910.22	3.00	14,730.66
	Germimi i pjesës humuzore të tokes kategorinë-II deri III-, në pjesën ku do të ndërtohet muga përkrah kanalit, sipas specifikacionit teknik dhe projekti të detajzuar. Ne llogaritje duhet të përfshirë edhe transporti i dheut të tepërt ne vendin e caktuar nga Autoriteti kontraktues i autorizuar - deponi te materialeve te ngurta " 353mx0.45x6.5		1,053.00	3.00	3,159.00
I.2	Furnizimi, plotësimi dhe ngjeshja e tabanit te kanalit. Moduli i ngjeshjes: Ms = 50MPa , sipas specifikimeve teknike dhe projektit te Detajuar	m2	4,105.08	0.30	1,231.52
	Furnizimi ,plotësimi dhe ngjeshja e gurit te thyer për tampon te muges. Fraksion: 100-150. Trashesia: th = 45 cm. Moduli kompakt: Ms =100MPa ne tabanin e kanalit dhe sipas specifikimeve teknike dhe projektit të Detajuar		1,275.75	7.00	8,930.25
I.3	Furnizimi ,plotësimi dhe ngjeshja e gurit te thyer ,nje shtresa: = Fraksion: 0-63, Trashësia: th = 15 cm Në mugë dhe tabanin e kanali. Moduli kompakt: Ms = 50MPa, dhe sipas specifikimeve teknike dhe projektit të Detajuar	m³	447.33	8.00	3,578.64
I.4	Furnizimi ,plotësimi dhe ngjeshja e gurit te thyer ,nje shtresa: = Fraksion: 0-31.5. Trashësia: th =5-10 cm Në mugë dhe tabanin e kanali. Moduli kompakt: Ms = 50MPa, ne baze të specifikimeve teknike dhe projektit te Detajuar	m³	888.88	8.00	7,093.44

"ISEFERI" SH.P.K.

	Germimi i dheut : lokes kategorine II deri III ,i pas standarteve per hapjen e hapesires per kanalet te mbyllura sipas specifikacioni teknik dhe projektit te detajuar. Ne rrjedhje dyfish te pershkrire edhe transporti i dheut te tepert ne vendin e caktuar nga Autoriteti kontraktues i autorizuar - deponi te materialeve te rigjuta." *Kanal: 133ml×24.5m3	m3	3,258.60	1.00	3,258.60
	Furnizim, plotësim dhe ngjeshja e tabanit te kanalit. Moduli i ngjeshjes: Ms = 50MPa, sipas specifikimeve teknike dhe projektit te Detajuar.	m2	877.80	0.30	263.34
	Furnizimi, plotesim dhe ngjeshja e gurit te thyer ,nje shtresor, = Fraksion: 0-63, Trashesia th = 20 cm Në mugë dhe tabanin e kanal, Moduli kompakt: Ms = 50MPa, dhe sipas specifikimeve teknike dhe projektit te Detajuar.	m3	175.56	8.00	1,404.48
	Mbushja ne shtresa moth mureve te kanalit me materialin e germuar dhe ngjeshja e tij ne shtresa	m3	744.80	1.00	744.80
				TOTAL:	44,394.63
II	**PUNET E BETONIT DHE BETONIT TE ARMUAR**				
II.1	Furnizim me të gjitha materialet e nevojshme ,pregatitja dhe betonimi I shtreses mbështetese me beton te thjeshtë -klasa C10/15 trashesia e shtresës jo 5-6 cm me saktesi -/ + 2cm për lavdrimin nën pllakën e Fundamentit	m3	361.84	54.00	19,539.12
II.2	Furnizim me të gjitha materialet e nevojshme, pregatitja e kallupeve dhe betonimi I pllakes se fundamentit te kanalit te mbuluar nga betonarmeja- klasa - C25/30 , i papershkueshem nga uji, sipas specifikimeve teknike dhe detaleve ne projekt trashesia e pllakes -t=40 cm , mirembajtja e betonit ,demontimi i kallupeve ,marrja dhe ruajtja e mostrave te betonit nga Laboratori i licencuar per shqyrtime te materialeve ndertimore L=133m	M3	373.75	90.00	33,635.70
II.3	Furnizim me të gjitha materialet e nevojshme, pregatitja e kallupeve dhe betonimi I mureve anesore te kanalit te mbuluar nga betonarmeja- klasa - C25/30 , i pa pershkueshem nga uji , sipas specifikimeve teknike dhe detaleve ne projekt trashesia e mureve t=30 cm , mirembajtja e betonit ,demontimi i kallupeve ,marrja dhe ruajtja e mostrave te betonit nga Laboratori i licencuar per shqyrtime te materialeve ndertimore	M3	148.96	90.00	13,406.40
II.4	Furnizim me të gjitha materialet e nevojshme, pregatitja e kallupeve dhe betonimi I pllakes se sipermi te kanalit te mbuluar nga betonarmeja- klasa - C25/30 , i pa pershkueshem nga uji , sipas specifikimeve teknike dhe detaleve ne projekt trashesia e pllakes -t=30 cm ,dhe vuzat ne fyt midis e pllakes mirembajtja e betonit ,demontimi i kallupeve ,marrja dhe ruajtja e mostrave te betonit nga Laboratori i licencuar per shqyrtime te materialeve ndertimore.	m3	313.88	90.00	28,249.20
II.5	Furnizim me të gjitha materialet e nevojshme, pregatitja e kallupeve dhe betonim I kapitenes grumbulluese ne fund te kanalit te mbuluar nga betonarmeja- klasa -C25/30 , i pa pershkueshem nga uji , sipas specifikimeve teknike dhe detaleve ne projekt trashesia e pllakes dhe mureve -t=20 cm , mirembajtja e betonit ,demontimi i kallupeve ,marrja dhe ruajtja e mostrave te betonit nga Laboratori i licencuar per shqyrtime te materialeve ndertimore.	m3	8.00	90.00	720.00
II.6	Furnizimi me të gjitha materialet e nevojshme, pregatitja e kallupeve dhe betonimi I grykes derdhese-dalese ne fund te kanalit te mbuluar nga betonarmeja- klasa -C25/30 , sipas specifikimeve teknike dhe detaleve ne projekt,trashesia e pllakes dhe mureve -t=20 cm , mirembajtja e betonit ,demontimi i kallupeve ,marrja dhe ruajtja e mostrave te betonit nga Laboratori i licencuar per shqyrtime te materialeve ndertimore	m³	30.00	90.00	2,700.00

II.7	Furnizim me te gjitha materialet e nevojshme, pregatitja e kallupeve dhe betonimi I pllakes dhe mureve anesore te kanalit te hapur me forme "trapezi" - nga betonarmeja- klasa -C25/30 - i pa pershkueshem nga uji - sipas specifikimeve teknike dhe detaleve ne projekt trashesia e pllakes dhe mureve t=20 cm - si dhe armatura sipas projektit dhe detaleve , mirembajtja e betonit demontimi i kallupeve ,mirrja dhe ruajtja e mostrave te betonit nga Laboratori i licencuar per shqyrtime te materialeve ndertimore. L+551	m3	822.16	90.00	73,993.50
II.8	Furnizim me te gjitha materialet e nevojshme, pregatitja e kallupeve dhe betonimi I pllakes (Urues) per kalim siper kanalit te hapur, me dimensione (5x6)m, trashesia e pllakes t=30 cm nga betonarmeja- klasa -C25/30, i pa pershkueshem nga uji , sipas specifikimeve teknike dhe detaleve ne projekt , sipas projektit dhe detaleve , mirembajtja e betonit ,demontimi i kallupeve ,mirrja dhe ruajtja e mostrave te betonit nga Laboratori i licencuar per shqyrtime te materialeve ndertimore ne 2 pozita punohen pllakat kalimi me dimensione: (5x6)m	m3	38.00	90.00	3,420.00
II.9	Fugat dilatuese (cdo - 20 m, mbushja e tyre me material elastik-"Sika flex construction", ne perimetar te prerjes terthore te kanalit (2o dhe 2h), ne 15 faqe	m'	108.60	50.00	5,430.00
II.10	Furnizim me te gjitha materialet e nevojshme dhe punimi I grilave metalike ne kaptazhin, grilat punohet nga celiku i zinguar ,dhe te ankerohen ne muret e betonit ,shufrat duhet te jene te galvanizuar dhe sipas specifikimeve teknike dhe projektit te detajuar	cop	3.00	150.00	450.00
				TOTAL:	181,543.92
III	PUNET E ARMATURES				
III.1	Furnizimi I materialit, pregatitja ,prerja lakimi dhe vendosja e armatures ndertimore ne shufra te cilesise S 500 ,shufra celiku sipas dimensioneve nga detalet e projektit dhe specifikacionit teknik	kg	155,700.00	1.00	155,700.00
				TOTAL:	155,700.00
IV	PUNET E KAPTAZHAVE(GRYKE-MBLEDHESEVE) NGA BETONARMEJA				
IV.1	Furnizimi me të gjitha materialet e nevojshme ,pregatitja e pahiva dhe betonimi I kaptazhave ,pllakave dhe mureve nga betonarmeja -trashesia e pllakes dhe mureve -t= 15 cm,si dhe armatura rrjete -fi 8mm (15 x 15)cm nje zone e armimit dhe sipas specifikimeve teknike dhe projektit te detajuar.	m3	75.00	90.00	6,750.00
IV.2	Furnizimi me të gjitha materialet e nevojshme dhe punimi I grilave metalike ne kaptazha, grilat punohet nga celiku i zinguar ,dhe te ankerohen ne muret e betonit ,shufrat duhet te jene te galvanizuar dhe sipas specifikimeve teknike dhe projektit te detajuar	cop	3.00	500.00	1,500.00
				TOTAL:	8,250.00
V	PUNET E TJERA				
V.1	Planifikimi i një sasie të dheut të gërmuar nëpër kanalit te hapur, në të dy anet	ml	567.00	1.00	567.00
V.2	Pastrimi i punishtes në fund gjatësin e kanalit nga te gjitha materialet ndertimore te mbetura ,dhe transporti I tyre ne deponi	m'	700.00	1.00	700.00
V.3	Pregatitja dhe punimi I projektit sipas ekzekutimit "As-built drawings", duhet te shtypet ne fund -1 ekzemplar ,si dhe nje kopje(CD-digitale- elektronike)	m'	700.00	1.00	700.00
				TOTAL:	1,967.00
	REKAPITULIMI I PUNEVE				
A.	PUNET EMOBILIZIMIT				950.00
I	PUNET E DHEUT dhe SHTRESAT E ZHAVORIT				44,394.63
II	PUNET E BETONIT DHE BETONIT TE ARMUAR				181,543.92

"ISEFERI"

III	PUNET E ARMATURES	155,700.00
IV	PUNET E KAPTAZHAVE(GRYKE-MBLEDHESEVE) NGA BETONARMEJA	8,250.00
V	PUNET E TJERA	1,967.00
	TOTAL -PUNET E KANALIT :	392,805.56

Vlera pa tvsh	332,886.06
Tvsh-ja 18 %	59,919.50
Vlera me tvsh	392,805.56